



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POLIÇAN

Adresa: Lagjia "Qender" Poliçan ; Tel:036824200 ; Email: [njvbashkiapolic@gmail.com](mailto:njvbashkiapolic@gmail.com)

Poliçan, me 28.04.2016.

Nr. 10819 Prot

**KONTRATE PROJEKT-ZBATIMI**

**"Pergatitja e projekt-zbatimit per rehabilitimin e Shtetores Miqësia"**

E lidhur sot me date 28.04.2016, ndermjet:

Autoritetit Kontraktues:

Bashkia Polican e perfaqesuar nga Z Adriatik Zotkaj Kryetar i Bashkise Polican, i quajtur Autoritetit Kontraktues dhe

Operatori ekonomik:

Aldor Karaja me nr nipt.K 92316013F me perfaqesues ligjor Z.Aldor Karaja me adrese Tirane , Rruga Myslym Shyri, Pallati 55, Shk.2, Ap.18 me cmim total i ofertes i shprehur ne lekes eshte 775.000 leke,(shtateqind e shtatedhjete e pese )leke pa tvsh

Neni 1

Objekti kontrates

Objekti i kontrates eshte "Pergatitja e projekt-zbatimit per rehabilitimin e Shtetores Miqësia" ne perputhje me specifikimet, sasite dhe cmimet e percaktuara ne oferten e paraqitur prej kontraktuesit ne oferten e tij.

Neni 2

Vlera e kontrates

Vlera e kontrates eshte 775.000 leke,(shtateqind e shtatedhjete e pese )leke pa tvsh

Neni 3

Afati kontrates

Pagesa do te kryhet ne monedhen shqiptare lek, brenda 30 diteve nga data e marrjes ne dorezimit te mallit

### Neni 8 Afatet e Pageses

1. Cmimi i kontrates, duke perfshire cdo pagese paraprake, duhet te paguhet ne kohe sic specifikohet ne kontrate.
2. Me perjashtim kur parashikohet nga nje dispozite tjeter ne kontrate, pagesa duhet here ne monedhe Shqiptare, Kursi i shkembimit i monedhave te ndryshme do te jete kursi i Bankes se Shqiperi se i fiksuar ne ditën e dergimit per botimin te njoftimit te kontrates.
3. Me perjashtim kur parashikohet nga nje dispozite tjeter ne kontrate, pagesa per projekt-zbatimin do te behet brenda 30 diteve kalendarike nga dita qe eshte pranuar projekti (eshte marr fatura) ose nga dita e marrjes se kerkeses per pagese cilado te jete me vone.
4. Data e pageses do te jete dita qe fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.
5. Pagesa e mallit do te kryhet brenda 30 diteve nga dorezimi i fatures.

### Neni 9

#### Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

Nese pas dates se nenshkrimimit te kontrates, ndonje ligj, rregullore, urdherese, urdher ose procedure me efektin e ligjit ne Republiken e Shqiperise hyn ne fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke perfshire datën e dorezimit, ose cmimin e kontrates, kushtet ose cmimi i kontrates do te rregullohen ne ate mase sa Kontraktuesi eshte ndikuar ne permbushjen e detyrimeve te tij sipas kontrates .

### Neni 10

#### Nderprerja per Mosplotesim

1. Autoriteti Kontraktor mund te nderprese kontraten ne teresi ose pjeserisht nese:
  - a) Kontraktuesi deshton ne realizimin e projekt zbatimit brenda periudhes se specifikuar ne kontrate ose brenda zgjatjes se dhene; ose,
  - b) Kontraktuesi deshton te zbatoje ndonje detyrim tjeter te kontrates.
2. Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim per nderpererjen per mosplotesim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 dite te ndreqe mosplotesimin me perjashtim kur

nderprerja eshte bere per veprime korruptive ose te paligjshme, rast ne te cilin nderprerja do te jete e menjehershme.

### Neni 11 Baza Ligjore

Kontrata do te rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise.

### Neni 12

#### Zgjidhja e Mosmarveshjeve

Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet te bejne cdo perpjekje te zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose ne lidhje me kete marrveshje me negociata direkte.

Nese palet deshtojne ne zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, problemet do te konsiderohen me ane te zgjidhjes se mosmarrveshjeve sipas kontrates dhe procedurave juridike ne fuqi sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise.

### Neni 13 Legjislacioni baze

1. Kjo kontrate te quhet e vlefshme duke filluar nga data e nenshkrimimit nga te dy palet. Shtesat e kesaj kontrate (nese jane te nevojeshme) do te quhen te vlefshme vetem pasi te jene aprovuar nga porositesi.
2. Te gjitha dokumentat e ketij prokurimi qe jane pranuar dhe firmosur nga operatori, jane pjese perberese e kesaj kontrate.

Kjo kontrate perbehet nga 4 flete dhe hartohet ne 3 (tre) kopje nga te cilat 1(nje) kopje e merr Operatori Ekonomik, 2 (dy) kopje Autoriteti Kontraktor.

AUTORITETI KONTRAKTOR  
ADRIATIK ZOTKAJ



OPERATORI EKONOMIK  
'KARAJA CONSULTING'  
ME PERFAQESUES

Z.Aldor Karaja

